



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 360/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Selvije Halimi nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Selvije Halimi nga koalicioni PDK-AAK-NISMA.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në Vendvotimin: 1307e/05R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Hetem Hetemi me nr. të letërnjoftimit [REDAKTUAR], në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 1307e/05R, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.06.2017, nga kandidatja për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Selvije Halimi nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se pas dëshmime të cilat i ka siguruar ajo 43 votat e saj janë bartur te kandidati tjetër

Parashtruesja e ankesës në cilësinë e provës si dëshmi ka bashkangjitur kopjen e FRK-së për vendvotimin 1307e/05R, në të cilin pretendon se ka pasur parregullsi.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 1307e/05R është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati me nr.27, nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, në komunën e Lipjanit, nuk ka asnjë votë, në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesja e ankesës i posedon 43 vota të vlefshme.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkritazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtrueses së ankesës nuk i janë regjistruar asnjë votë në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se e njëjta i posedon 43 vota.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par.3 Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 360/2017 më datën 02.07.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjespranimit të këtij vendimi.